



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**
P-nr.20/2021

Prishtinë, më 07.10.2021, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Tinka Kurti, Albana Bytyçi, Saranda Bogujevci, Alban Bajrami, Vasfije Krasniqi. Fjolla Ujkani dhe Ariana Musliu –Shoshi.

Munguan: Eliza Hoxha Marigona Geci dhe Milosh Peroviq.

Stafi mbështetës i komisionit Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Andin Hoti, kryesueses i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Kushtrim Gara, udhëheqës i Zyrës për Persona të Zhdukur, Valdrin Krasniqi, ushtrues i detyrës së drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës,

Astrit Hoti, drejtor i Departamentit Ligjor në Këshillin Gjyqësorë të Kosovës, Arbresha Asllani, AAK, Melihate Krasniqi, GGD, Vlora Gashi, GP/VV, Fitore Berisha, EkonomiaOnline, Mehmet.... KTV, Shqipe Pajaziti, Kosova Press, Bardh Fetahu, Kuvendi, Gentiana Ahmeti, BIRN, Adea Koci, KDI, Agnesa Haxhiu, KDI, Agim Sulaj, AA, Fikreta Radonçiq-Kuvendi i Kosovës dhe Doruntina Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi Duda Balje, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura me dt. 17 dhe 21 shtator 2021.
3. Takim në Komision, të ftuar:
 - Përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur.
4. Takim në Komision, të ftuar:
 - Përfaqësuesit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe të Këshillit Gjyqësor

- të Kosovës;
5. Shqyrtimi i Peticioneve;
 6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura me dt. 17 dhe 21 shtator 2021.

Kryetarja konstatoi se procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura me dt. 17 dhe 21 shtator 2021, u miratuan pa vërejtje.

3. Takim në Komision, të ftuar:

- Përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur.

Kryetarja tha se prezent janë përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, kjo temë është shumë e rëndësishme për vendin tonë dhe na intereson të dimë se si qëndrojmë si Kosovë.

Andin Hoti tha se si Komision Qeveritarë për Persona të Zhdukur e konsiderojmë të nevojshme bashkëpunim me Komisionin e juaj Parlamentar pasi që kjo temë përveç që është e ndjeshme kërkon edhe unifikim dhe nevojën e bashkëpunimit të të gjitha institucioneve në mënyrë që të arrijmë deri te rezultati, kjo çështje është e komplikuar dhe nuk ka të bëjë vetëm me territorin e Kosovës.

Tha se ka tre muaj që e ka marrë këtë pozitë në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht është edhe kryetar i delegacionit të Kosovës për bisedime për çështjen e personave të zhdukur në grupin punues me Serbinë. Prej asaj kohe deri më tash kemi ri funksionalizuar komisionin, ku përveç përbërjes së saj që ka katër zyrtarë që është sekretariati i komisionit i ka edhe dymbëdhjetë anëtarë të tjerë të komisionit, të ministrive të ndryshme me të cilët bashkëpunojmë në vazhdimësi dhe kemi mbajtur mbledhje me ta.

Njëkohësisht si komision në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Drejtësisë jemi duke punuar në ndryshimin e ligjit për persona të zhdukur, për momentin ky projektligj pritet që brenda afatit tetor-nëntor të përfundojë dhe pastaj të përcillet tutje.

Në kuadër të këtij Projektligji janë adresuar edhe kërkesat tona si komision, por edhe kërkesat tjera të familjarëve të personave të zhdukur që kanë të bëjnë edhe me prekjen e ligjeve tjera si është ligji për kategoritë e dala nga lufta dhe ligji për pensionet, dhe ne konsiderojmë se familjarët e personave të zhdukur kanë të drejtë të kenë benefite të tjera krahas atyre që i kanë.

Njëkohësisht e kemi adresuar edhe një rekomandim që ligji për persona të zhdukur emërtimi mos të quhet më ligj për persona të zhdukur, por ligj për persona të zhdukur me forcë sepse, këta persona që janë zhdukur në luftë nuk janë zhdukur nga vetë dëshira, por janë kidnapuar dhe janë zhdukur si pasojë e marrjes me forcë.

Kërkojmë edhe përkrahjen e juaj si deputet për miratimin e ndryshimit të emërimit të këtij ligji, ka fatkeqësisht disa vite që baza nuk ka funksionuar dhe kemi arritur që me funksionalizuar të plotë, ku ne, si komision institucionet, e relevante por edhe familjarët e personave të zhdukur me kërkesë të tyre kanë qasje dhe mund të keni

formacione të plota se çka ka ndodhur dhe çka po ndodh me statusin e familjarit të tyre, që është person i zhdukur apo edhe është identifikuar.

Në territorin e Republikës së Kosovës janë disa urdhëresa që janë lëshuar prej Prokurorisë së Kosovës, urdhëresa të hulumtimeve në lokacione brenda territorit të Kosovës, kemi filluar me punuar në disa lokacione, dhe për hir të asaj që mos t'i shqetësojmë familjarët nuk e kemi bërë publike se ku jemi duke punuar. Në Kosovë janë pesë lokacione me prioritet që kemi urdhëresa dhe jemi duke punuar, prioritet mbeten lokacionet në Serbi, sepse në baze të praktikave dhe informacioneve që kemi nuk janë vetëm pesë lokacionet që deri tani kemi hulumtuar dhe gjetur trupa në Serbi por informacionet na çojnë në dyshime se mund të ketë varreza të tjera masive në territorin e Serbisë.

Një nga sfidat kryesore që e kemi trajtuar edhe në Bruksel është edhe qasja në arkivat shtetërore të ushtrisë së Serbisë, të cilat konsiderohen të klasifikuara me ligje të Serbisë aktualisht, pra arkiva që kanë të bëjnë me luftën e fundit në Kosovë, dhe këto arkiva do të kishin ndihmuar në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Ai tha se brenda këtij viti kanë qenë 21 identifikime në total, 19 prej tyre janë të komunitetit shqiptar dy prej tyre janë të komunitetit serb, e dini se janë gjetur 7 trupa të personave të vrarë në masakrën e Rezallës e pastaj janë rivarrosur në varrezën masive në Kizhevak dhe janë gjetur dy ribashkime të trupave që janë gjetur vite më parë në një lokacion tjetër brenda territorit të Serbisë.

Tha kemi bashkëpunim të mirë me bashkësinë ndërkombëtare për këtë çështje dhe vazhdimisht kërkojmë që të rrisim presionin ndaj Serbisë që këtë çështje në radhë të parë mos ta trajtojë politike, por të trajtojë humane dhe në radhë të dytë të jetë e gatshme për bashkëpunim të plotë sa i përket çështjes së personave të zhdukur.

Kemi kërkuar nga z. Lajcak, që kjo çështje të ketë një afat kohor dhe të ketë një epilog sepse kjo çështje nuk mund të shkojë në pafundësi, parimisht jemi pajtuar që një gjë e tillë të ndodhë por ende nuk kemi një marrëveshje të tillë.

Ai tha se kemi disa urdhëresa me kërkesë të palës serbe për disa lokacione në Kosovë, dhe këto i kemi në agjendë, por tani për shkak të motit nuk mundemi dhe për fillimin e punës në këto lokacione do të presim deri vitin e ardhshëm.

Kryetarja tha se qëllimi i takimit ka qenë marrja e informacioneve dhe kërkoj që kur të keni takime të rëndësishme me inkuadruar edhe një anëtar të këtij komisioni parlamentar. Ajo pyeti se ku qëndron Kosova më dobët lidhur me gjetjen e personave të zhdukur brenda dhe jashtë Kosovës, dhe si mundemi ne, si komision, me bërë presion në Serbi, në cilat adresa mundemi me bërë presion për të marrë informata për lokacionet.

Andin Hoti tha se në komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur një prej mungesave që e ka vërejtur është mungesa e stafit dhe kam kërkuar që të ketë ngritje të kapaciteteve njerëzore dhe kam kërkuar prej ambasadave të cilat na mbështesin dhe të na asistojnë edhe me kapacitete njerëzore. Fatkeqësia është që kemi të bëjmë me një vend si Serbia dhe presionin që mund ta bëjmë nuk do të ketë rezultat, ku ne mundemi të bëjmë presion është Bashkimi Evropian, që ato pastaj të kushtëzojnë Serbinë që çështjen e personave të zhdukur ta trajtojë në mënyrë humane dhe të jetë bashkëpunues në plotëni për këtë çështje.

Si Kosovë kemi Institutin e Mjekësisë Ligjore, Policinë e Kosovës që është shumë e angazhuar është Prokuroria e Kosovës dhe natyrisht edhe me Kuvendin, dhe se te mangët e konsideroj mungesën e kapaciteteve njerëzore në Komisionin Qeveritar, presioni mbi Serbinë do të jetë përmes Bashkimi Evropian.

Saranda Bogujevci tha se kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me KQPZH, por jam e mendimit që Komisioni Parlamentar duhet të luaj një rol më aktiv, për këtë temë jemi edhe të thirrur për ta trajtuar, më tej pyeti çka konkretisht si Komision Parlamentar mundemi me ndërmarrë për me e shtyje çështjen e të pagjeturve para, për këtë mundeni me u përgjigj jo patjetër tani tha ajo, të gjithë jemi të gatshëm me ndihmuar në këtë proces.

Andin Hoti tha se do ta trajtojmë me seriozitet mundësin e dërgimit të një anëtari nga Komisioni Parlamentare në KQPZH, dhe natyrisht këtë po e konsiderojmë si anëtarin e tretë të komisionit dhe për çdo lloj nevojë që kemi si Komision Qeveritar do i adresohemi anëtarit të Komisionit Parlamentare që është caktuar nga ana e juaj dhe përmes tij/saj kontaktojmë edhe me ju. Ju keni kontakte edhe me miq ndërkombëtarë dhe është mirë t' u qartësohet miqve ndërkombëtarë se Kosova vazhdon me trajtuar çështjen e personave të zhdukur si çështje humane dhe se pala serbe nuk po e bënë një gjë të tillë.

Aktualisht personat e zhdukur janë gati se pa status të ndryshuar, konsiderohen si viktimat dhe mendoj se këtu mundeni me na ndihmuar si Komision Parlamentar, sepse sidomos familjarët e tyre që 22 vite që presin e nuk mendoj që thjesht duhet me u konsideruar viktimat.

Kryetarja: U përmend se keni mbi 25 shoqata, kemi takuar dhe biseduar me 5 apo 6 shoqata, si është bashkëpunimi mes shoqatave kjo është e rëndësishme sepse ata kanë shumë informata, ata kanë pasur disa kërkesa konkrete a keni provuar me i involvuar kërkesat e tyre në projektligj.

Andin Hoti: Në projektligjin që është duke u punuar janë tre anëtarë të shoqatave jo qeveritare të involvuar në grupin punues, është Asociacioni i Shoqatave që i bashkon të gjitha ato shoqata, shumica prej tyre funksionojnë sa i përket bashkëpunimit me shoqatat do të japë maksimumin dhe si Komision Qeveritar e kemi bashkëpunimin e plotë deri më sot.

Fjolla Ujkani pyeti a ka hezitim nga institucionet e tjera relevante që me ju dalë në ndihmë dhe me ju asistuar në çështjet të cilat ju i shihni të arsyeshme që ata mund të japin ndonjë kontribut më të madh dhe a ka ndodh që shoqatat të cilat merren me çështjen e personave të zhdukur të mos kenë një bashkëpunim të mirëfilltë mes vete dhe të kenë një kërkesë konkrete karshi Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe që ju nuk keni arritur me gjet dakordim mes vete, se si me ushtruar një çështje të caktuar dhe një kërkesë specifike nga ana e tyre.

Andin Hoti tha se prej se ai është në krye te këtij komisioni nuk ka hasur në asnjë hezitim të institucioneve tona vendore, tha se është sfidë çështja e kapaciteteve njerëzore dhe edhe te institucionet tjera relevante zyrtarët që janë caktuar si anëtarë të Komisionit Qeveritar njëkohësisht janë zyrtarë që punojnë në ato institucione në fusha të tjera që janë të punësuar dhe natyrisht kjo mund të jetë sfidë për ta.

Tha se shoqatat mund të kenë jo dakordim mes vete, por për këtë tha se nuk është i njoftuar, shtoi se prej se është në komision kanë bashkëpunuar të gjitha me komisionin.

Ariana Musliu-Shoshi pyeti cili është bashkëpunimi i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur me z. Besnik Bislimi, që është i ngarkuar me punë për dialog në Bruksel ku përfshihen edhe personat e pagjetur dhe pyetja tjetër ka të bëjë me vështirësitë që ju i keni sa i përket konsolidimit si delegacion në Bruksel dhe kur do të jetë takimi i radhës në Bruksel lidhur me personat e zhdukur.

Andin Hoti tha se nuk është anëtarë i delegacionit të Brukselit, tha se ka qenë i ftuar vetëm herën e fundit si kryesues i KQPZH-së, sepse ka qenë i paraparë takimi në mes tij dhe grupit punues të delegacionit serb, mirëpo, një takim i tillë nuk ka ndodhur për shkak të provokimit të palës serbe me delegimin e z. Ovdaloviq, në Bruksel edhe pse kanë qenë në dijeni se ne nuk mund të ulemi në të njëjtën tavoline me të. Një takim i imi me z. Bislimi dhe z. Lajçak, dhe kem kërkuar që të ketë një afat kohor 1, 2 apo 3 vite, ku familjarët duhet të kenë përgjigjeje për fatin e personave të zhdukur dhe për këtë në parim jemi pajtuar, nuk është arritur marrëveshje.

Ai shtoi se bashkëpunimin me z. Bislimi, natyrisht se është i mirë sepse është zëvendëskryeministri i parë dhe është i deleguar për çështjen për integritet evropiane dhe krahas saj për çështjen e persona të zhdukur.

Tinka Kurti tha se shpreh gatishmërinë për të ndihmuar punën e Komisionit Qeveritar, u përmend nevoja e ndërkombëtarizimit të çështjes se personave të zhdukur, për këtë të mendojmë të dy palët për një aktivitet, kanë kaluar shumë vite dhe ka pasur shumë aktivitete sipas nevojës. Duhet të mendojmë ndoshta për një ekspozitë të përhershme, një muze qoftë edhe nëse gjinden të gjithë personat që ende janë të zhdukur për hir të viteve që kanë kaluar, për hir të atyre eshtrave që janë kthyer, kjo të jetë një aktivitet i përbashkët të përfshihen organizata ndërkombëtare me karakter humanitar.

Andin Hoti tha se pajtohet që të intensifikojnë bashkëpunimin mes vete dhe të ketë aktivitete të përbashkëta, qoftë edhe me miq ndërkombëtarë, sepse bëjmë presionin përmes tyre, jemi duke punuar dhe beson se kanë me pas aprovimin e qeverisë që në Merdare ku janë riatdhesuar shumë trupa prej Serbisë, të jetë një përkujtimore ku të dihet se përmes asaj pike janë riatdhesuar përafërsisht 1000 njerëz tanë, ku është tentuar të humbin gjurmët e tyre, besoj se një gjë e tillë do ndodh shume shpejt me aprovimin e Qeverisë.

Ariana Musliu-Shoshi tha se e dinë që nuk është pjesë e delegacionit në Bruksel, por konsideroj se në tavoline në Bruksel nuk duhet që të flitet për persona të zhdukur me forcë dhe ju të mos jeni prezent, kjo nuk është e mirë dhe nuk na shërben neve si shtet, dhe pyetja tjetër ishte se a keni një takim se shpejti në Bruksel për temën e personave të zhdukur.

Kryetarja pyeti a ka Kosova shifra se sa persona të komunitetit serb janë të zhdukur nga Kosova dhe a është shifër e njëjtë me data bazën e Serbisë.

Andin Hoti tha se në takimin me z. Lajçak, z. Bislimi dhe z. Ovdaloviq, nuk ka marrë pjesë sepse niveli i tij i kryetarit të KQPZH –së nuk është i nivelit të njëjtë, sepse ata e kanë përfaqësuar nivelin politik, në Bruksel nuk është mbajtur një takim i nivelit të tij d.m.th. me kryesuesin e Komisionit Qeveritar nga Serbia, sa i përket takimit të radhës tha se nuk ka njohuri kur do të mbahet dhe a do të jetë ai në atë takim.

Kushtrim Gara tha se në Kosovë personat e zhdukur asnjë herë nuk janë trajtuar ndaras në bazën e kuptimit të ndarjes etnike, gjinore, fetare apo edhe në rast se personi i zhdukur ka qenë civil apo me uniform ushtarake, gjithnjë në respektim të drejtës së familjes për të ditë fatin e vend ndodhjes për të dashurit e tyre. Këtë të drejtë e kanë gëzuar në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës, por edhe me Konventa Ndërkombëtare që trajtojnë këtë çështje. Ka qenë një tentim i ndërkombëtarëve që gjithnjë personat e zhdukur të trajtohen në mesin e atyre shqiptarë dhe jo shqiptarë, por duke pasur parasysh parimin e mos diskriminimit asnjëherë rastet nuk janë trajtuar në bazë të përkatësisë etnike. Sa i përket asaj se të dhënat a janë të njëjta me të palës serbe, tha se të dhënat që i disponojnë i pranojnë edhe organizatat me integritet ndërkombëtarë që kanë qenë pjesë e këtij procesi, por diku mund të jetë shifra prej 20 për qind që nuk janë shqiptarë.

Kryetarja, në fund, konstatoi se si Komision Parlamentar do ta dërgojmë një anëtarë të komisionit që të jetë pjesë e takimeve me ju dhe kjo është rëndësishme sepse do t' i kemi informatat nga dora e parë lidhur me çështjen e personave të zhdukur.

4. Takim në Komision, të ftuar:

- Përfaqësuesit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryetarja tha se ju jeni prezent këtu në bazë të një peticioni që kemi pranuar nga z. Fehmi Zena, besoj se ju keni informata dhe na jepni shpjegime lidhur me këtë rast.

Astrit Hoti, KGJK, tha se lidhur me rastin e z. Fehmi Zena, i cili ka qenë i punësuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, e cila zyre i ka hartuar raportet disiplinore edhe për gjyqtarë edhe për prokurorë, me hyrjen në fuqi të ligjit për përgjegjësit disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë atëherë kjo zyre është shuar për arsye se ka filluar një procedurë e re e disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në koordinim me Këshillin Prokurorial, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka bërë një listë të zyrtarëve të cilët kanë qenë duke punuar në këtë zyre dhe në bazë të vullnetit të tyre ata kanë përcaktuar se në cilin institucion do të punojnë. Z. Zena, në listë ka shkruar se do të punojë në KGJK ose në KPK, pas shpërndarjes së punëtorëve të kësaj zyre ai është bërë pjesë e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe atje ka punuar disa muaj deri në momentin kur KPK i ka ofruar një kontratë të cilin ai nuk e ka pranuar dhe ka filluar mos pajtimi i tij. Ai ka kërkuar të emërohet si drejtor i Departamentit të Personelit në KGJK ose KPK, dy institucionet e kanë refuzuar, ai ka bërë ankesë në komisionin e ankesave në kuadër të Sekretariatit të KGJK-së, është refuzuar ankesa për shkak se kemi konsideruar se nuk është punëtorë i Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, por është punëtorë i Këshillit Prokurorial.

Valdrin Krasniqi tha se me peticionin që e përmendi zonja kryetare, si Këshill Prokurorial nuk e kemi pranuar, nuk di se çka përmban peticioni i ngritur nga z. Zena, ne pas pranimit të listës së vullnetit të shprehur të zyrtarëve të ish ZPD-së, kemi marrë vendime në pajtim me legjislacionin në fuqi, në atë mënyrë që zyrtarët të cilët kanë shprehur vullnetin për të qenë pjesë e KPK-së përkatësisht sekretariatit të Këshillit Prokurorial me një vendim të drejtorit të Sekretariatit të KPK-së, është vendosur që përkohësisht të vendosen në kuadër të strukturës organizative që nënkupton divizionin për administratë, në atë mënyrë që përshkrimi i detyrave të tyre të punës mbetet i njëjti po

ashtu edhe koeficienti apo niveli i pagës mbetet i njëjti deri në riorganizimin e administratës.

Me dt.1 korrik të viti 2019, drejtori i Sekretariatit ka nënshkruar aktin e emërimit dhe të njëjtin ja ka ofruar për nënshkrim apo për pranim të tij z. Zena, i njëjti duke mos u përgjigjur në vazhdimësi nuk e ka pranuar aktin e emërimit, nga data 1 korrik kur i është ofruar akti i emërimit, kemi pritur z. Zena për t' u deklaruar se a dëshiron të jetë pjesë e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial- Divizioni për Administratë, me titullin që e ka pasur në ish- Zyrën e Prokurorit Disiplinor që ka qenë drejtor i zyrës së shërbimeve të përgjithshme me koeficientin 17.2, në akt emërim kohëzgjatja i është prezantuar pa afat për arsye se të njëjtin akt emërim e ka pasur edhe me ish ZPD. I njëjti nuk e ka pranuar aktin e emërimit me qëllimin sepse dëshiron të jetë pjesë e një departamenti tjetër përkatësisht atë për burime njerëzore, administratë dhe prokurim, që në atë kohë ka qenë duke e ushtruar një ushtrues detyre. Arsyet pse të njëjtit nuk i është ofruar pozita e kërkuar si drejtor i Departamentit, kanë qenë dy; për shkak se nivelin të cilin ai e ka ushtruar në ish ZPD, si udhëheqës i zyrës tek ne në Sekretariat është niveli më i ulët i nivelit të njësisë organizative sepse struktura organizative e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës është në atë mënyrë që është drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit që është zyrtari kryesor administrativ, është udhëheqësi i departamentit, divizionit dhe zyra, prandaj nuk ka korresponduar niveli i tij drejtor i zyrës me nivelin e udhëheqësit të departamentit për shkak se ka një shkëputje të niveleve të pozitive mirëpo, në vendimin të cilin i është lëshuar kjo ka pasur të jetë deri në riorganizimin e administratës. Përveç z. Fehmi Zena të gjithë zyrtarët e tjerë janë riorganizuar në kuadër të Këshillit Prokurorial, sipas ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, e kanë pranuar aktin e emërimit.

Ne, për momentin, jemi në riorganizim të administratës dhe do mundohemi t' i trajtojmë këto kërkesa të tyre që tani me këta zyrtarë që janë transferuar në kuadër, përkatësisht Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të njëjtit do t' u ofrohen akt emërim komfor pozitive të cilat i kanë pas në pozicionet e kaluara.

Ai tha se z. Zena, nuk e ka nënshkruar aktin e emërimit prandaj drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial pas pritjes një muaj e gjysmë për nënshkrim përkatësisht me dt.16 gusht të vitit 2019, ka marrë vendim me të cilin e ka revokuar aktin e emërimit të cilin i është ofruar z. Zena, dhe të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në kuadër të sistemit prokurorial.

Kryetarja tha se z. Zena, ka bërë ankesë edhe te Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë një përgjigjeje shumë koncize dhe të qartë dhe në fakt ka konstatuar se ankesa është e arsyeshme dhe ka pasur shkelje të drejtave themelore të njeriut.

Tink Kurti pyeti të ftuarit se a kanë par konkluzionet e Institucionit të Avokatit të Popullit, ato vendimet zakonisht janë edhe ne web- faqe kjo është e vitit 2019, atë kohë Avokat i Popullit ka qenë Hilmi Jashari, IAP ka menduar se ka pasur shkelje të drejtave themelore të njeriut dhe kjo ka qenë njëra, dhe ishte shkelje edhe mos lejimi i qasjes në vendin e punës.

Kryetarja tha se këtu se në bazë të gjitha provave që ka z. Zena, ka shkelje të ligjit në bazë të raportit të Avokatit të Popullit, të gjitha janë paraqitur me fakte me pika të ligjit që i keni shkel dhe keni shkel ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës.

Astrit Hoti tha se z. Zena me vetë dëshirë ka pranuar të shkoi në Këshillin Prokurorial, për këtë tha se kemi listën, tha se e din nga Praktika se Avokati i Popullit i konsulton

institucionet lidhur me ankesat që paraqiten, por nuk e din që kanë pranuar një ankesë nga Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me këtë rast por, tha se si do që të jetë provat dhe faktet i dhamë dhe tjetër nuk kanë çka të japin, mirëpo ligjin nuk e kemi shkel, atë qe ka shkruar IAP nuk e kemi parë, i njëjti lëndën e ka edhe në gjykatë në kontest administrativ dhe sido që të jetë është mirë t' ia lëmë besimin gjykatës dhe me siguri gjykata e ka rekomandimin e Avokatit të Popullit. Dhe e them se KGJK nuk e ka shkel ligjin sepse me vet dëshirë ka shkruar në KPK dhe për këtë posedoj listën ku është nënshkruar, dhe ai te ne nuk ka qenë në punë, ai ka punuar në KPK për një muaj e gjysmë dhe për këtë periudhë nuk ka pasur ankesë të KGJK.

Tinka Kurti tha se IAP nuk e ka për obligim t' i kontaktojë të gjitha palët që preken në të gjitha rastet.

Valdrin Krasniqi tha nga praktika, por edhe nga Legjislacioni në fuqi për Avokatin e Popullit momentin kur ngritët një çështje, në qoftë se ka qenë një ankesë për Këshillin Prokurorial apo Këshillin Gjyqësorë, Avokati i Popullit do duhej të na drejtohej me kërkesë ku ne jemi të obliguar të ofrojmë përgjigjeje konkrete komfor kërkesës se Avokatit të Popullit. Meqë nuk na është ofruar mundësia për t' u përgjigjur para Avokatit të Popullit lidhur me pretendimet e z. Zena, atëherë e kemi të pamundur për t' u përgjigjur e për më tepër për të konkluduar se kemi bërë shkelje të ligjit.

Alban Bajrami u tha që rasti ka shkruar në gjykatë a jeni të informuar, dhe në rast se ka shkruar lënda në gjykatë i bie se gjykata ju ka kontaktuar juve dhe i ka nda provat, mundeni me qenë të painformuar ju në rastin konkret, por jo institucioni mos me qenë i informuar se rasti ka shkruar në gjykatë, tha se në vitin 2019, në KPK është hapur një pozitë e lirë kur po flasim në lidhje me z. Zena, kur po thuhet se nuk ka pasur mundësi me u vendos në një pozitë të njëjtë.

Astrit Hoti tha se arsyeja pse ka shkruar në gjykatë është se ai fillimisht është ankuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, aso kohe Këshilli nuk ka pasur anëtarë për të vendosur dhe procedura t'i udhëzon palët për me shkua në gjykatë, përndryshe ne ende nuk kemi pranuar nga gjykata zyrtarisht dokumente që ne duhet mu përgjigj.

Valdrin Krasniqi tha se është e vërtetë që është bërë shpallja avancim në karrier, por z. Zena edhe pse se ka pranuar aktin e emërimit të njëjtit përmes një shkrese i është ofruar mundësia për të aplikuar në një proces meritokratik që të avancohet në atë pozitë, i njëjti nuk ka aplikuar për atë pozitë dhe pas përfundimit të afatit të aplikimit i njëjti ngrit ankesë.

Ndërsa sa i përket gjykatës me plot kompetence them se zyrtarisht nuk jemi të informuar se ka një padi ndaj Këshillit Prokurorial lidhur me këtë lëndë.

Albana Bytyçi pyeti se a kanë qenë në këto pozita kur z. Zena, ka iniciuar peticionin dhe a keni qenë në dijeni se ka iniciuar peticion, dhe a është tash në funksion zyra ku ka qenë z. Zena në pozitë.

Astrit Hoti tha se ai është në të njëjtën pozitë, dhe si KGJK nuk kanë asnjë obligim ndaj z. Zena, sepse ai ka deklaruar vet për me shkruar në KPK.

Alban Bajrami, lidhur me raportin e Avokatit të Popullit të cilin ju nuk e keni apo konfirmoni një gjë të tillë.

Valdrin Krasniqi tha se me kompetencë e them se Këshilli Prokurorial nuk ka prej Avokatit të Popullit të pranuar një raport për këtë.

Kryetarja tha se ne morëm mendimin e juaj se ju nuk keni shkelur as ligjin as liritë dhe të drejtat e njeriut si Këshilli Gjyqësorë e as Këshilli Prokurorial.

Kryetarja konstatoi se komisioni vendosi t' i drejtohet Institucionit të Avokatit të Popullit, me kërkesën për të njoftuar komisionin lidhur me atë se me mendimin juridik dhe konkluzionet e Institucionit të Avokatit të Popullit, a janë njoftuar Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe a ka qenë IAP, i obliguar për t'i njoftuar dhe dërguar mendimin juridik, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

5. Shqyrtimi i Peticioneve

Kryetarja, konstatoi se kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e radhës.

6. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati çështje për t' u diskutuar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Duda Balje,
Kryetare e Komisionit